



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
REPUBLICA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION  
Nro. 1053/25  
Dok. No. 1053/25  
Data: 26.06.2025  
Nr. Page: 1  
Date: 26.06.2025  
Nr. Page: 1  
Data: 26.06.2025  
PRISHTINE  
LABORATORIUM ETHICUM  
SINE CORRUPTIONE

Në bazë të Nenit 12, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), si dhe në kuptim të zbatimit të Nenit 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1.2, Nenit 20, 21 dhe 22 të Ligjit, Nenit 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 26.06.2025, nxjerr:

## V E N D I M

### Për kontroll të plotë sipas shortit të të dhënave nga deklarimi i pasurisë

1. Agjencia do të bëjë kontrollin e plotë sipas shortit për vitin 2025, për subjektet deklaruese përmes sistemit DMSA, nga data 01.01.2025 deri më 25.06.2025.
2. 232 zyrtarë të lartë/subjekte deklaruese nga 420, të kategorizuar sipas Nenit 4, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1 deri në 1.18 të Ligjit Nr. 08/L-108, do t'i nënshtrohen kontrollit të të dhënave të deklaruara sipas Nenit 18, paragrafi 11.
3. 1125 zyrtarë të lartë/subjekte deklaruese nga 3497, të kategorizuar sipas Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafët 1.19 deri në 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-108, do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë sipas Nenit 18 paragrafi 12 të ligjit.
4. Subjektet deklaruese të kategorizuara sipas Nenit 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.21, të cilët nuk kanë qenë pjesë e kontrollit të plotë për dy vitet paraprake, do t'i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit të plotë të pasurisë nga Agjencia, sipas Nenit 18 paragrafi 12 i ligjit.
5. 150 zyrtarë publik/subjekte deklaruese, të kategorizuar sipas Nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-108, do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë sipas Nenit 18 paragrafi 9, të ligjit.
6. Obligohet Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme operacionale në vazhdim, për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve brenda Departamentit sipas legjislacionit në fuqi.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

## A r s y e t i m

Duke u bazuar në përgjegjësitet e Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, në raport me mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive sipas ligjit, dhe atë në pajtim me Nenin 18 të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Agjencia për Parandalimin e Korruptionit çdo vit bën kontrollin e plotë të deklarimeve të pasurisë së subjekteve deklaruese sipas ligjit të përzgjedhur me short.

Prandaj, subjektet deklaruese të kategorizuara sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-108, të përcaktuara si në dispozitiv të këtij Vendimi, do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë nga Agjencia lidhur me të dhënat e deklaruara, si dhe saktësisë të tyre.

Kontrolli i plotë për kategorinë e zyrtarëve të lartë/subjekteve deklaruese si në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit, përfshin kontrollin dhe verifikimin e diferencave në pasurinë e deklaruar sipas kategorive të përcaktuara ligjore, dhe atë deklarimet mbi 25,000.00 euro.

Për kategorinë e zyrtarëve të lartë/subjekteve deklaruese të theksuar në pikën 3 dhe 4 të dispozitivit të këtij Vendimi, Agjencia do të bëj kontrollin e plotë sipas ligjit, duke përjashtuar ata të cilët kanë qenë pjesë e kontrollit të plotë vitin e kaluar. Për më tepër, kategoria e zyrtarëve publik, subjektet deklaruese si: anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe anëtarët e Këshillit Prokurorial, gjyqtarët dhe prokurorët, të përcaktuar me Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.21, të cilët nuk kanë qenë pjesë e kontrollit dy vitet paraprake, Agjencia sigurohet që të njëjtit t'i nënshtrohen këtë vit kontrollit dhe verifikimit të plotë të pasurisë.

Ndërsa për kategorinë e zyrtarëve publikë/subjekteve deklaruese sipas pikës 5 të dispozitivit të këtij Vendimi, Agjencia do të bëj kontrollin e plotë për numrin e zyrtarëve të përzgjedhur, brenda mundësive dhe kapaciteteve njerëzore.

Nga ajo që u theksua në arsyetim u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Drejtorit;
- Departamentit për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave;
- Arkivës;